




Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është entitet juridik i pavarur me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditore për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM), duke ndarë riskun kreditor me institucionet financiare.

RRITJA E KREDITIMIT PËR NMVM-TË NË KOSOVË

Përmes garantimit të portofolit kreditor të institucioneve financiare, ne synojmë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë, mbështetjen e prodhimit vendor dhe të atyre shërbimeve të cilat krijojnë vlerë të shtuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.



DRITARJA AGRO


Kapitali për Dritaren Agro është nga KfW

Deri më tani:

12.06 milion euro kredi të lëshuara nga IFR-të

5.87 milion euro të garantuara nga FKGGK


Të shpërndarë në 302 Agro Kredi.



SHPËRNDARJA SEKTORIALE


Shpërndarja e portofolit të FKGGK-së nëpër sektorë të ndryshëm pasqyron ekonominë e vendit.

KREDITË SIPAS SEKTOREVE



KRIJIMI I VENDEVE TË PUNËS

Krijimi i vendeve të reja të punës është një nga objektivat kryesore të themelimit të FKGGK-së. 4,637 kredi për NMVM-të parashikojnë 6,986 vende të reja pune.



KREDITË PËR GRATË NË BIZNES

Mundësi më të mira për sektorët dhe për kategoritë më pak të shërbyera ekonomike dhe të popullsisë, duke përfshirë gratë, është një objektivi tjetër i rëndësishëm për FKGGK-në.

Nga 4,637 kredi për NMVM-të, 12% janë lëshuar për gra pronare/bashkëpronare në biznes.



RRITJA E QARKULLIMIT

Deri më 31 mars 2020 4,637 kredi për NMVM-të parashohin 191.4 milion euro rritje të qarkullimit mbi bazën e tanishme të qarkullimit të NMVM-ve përkatëse.



BASHKËPUNËTORËT E FKGGK-SË

FKGGK-ja bashkëpunon me institucionet financiare (bankat, IMF-të, IBJF-të), me donatorët, me Qeverinë e Kosovës, me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me Komunitetin e NMVM-ve.

DONATORËT	BASHKËPUNËTORËT	INSTITUCIONET FINANCIARE TË REGJISTRUARA
Qeveria e Kosovës Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID Banka Zhvillimore Gjermane -KfW	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – SIDA, e përfqësuar nga Ambasada Suedeze Fondi Investues Europian-EIF (COSME - Konkurrueshmëria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme) Fondacionin Mileniumi i Kosovës (MFK)	Banka Ekonomike Banka Kombëtare Tregtare Banka për Biznes NLB Banka ProCredit Bank Raiffeisen Bank TEB Raiffeisen Leasing Kosovë

Arritjet e Fondit deri më datë 31 mars 2020

